



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština – Assembly*

---

**Legjislatura III**

Komisioni për Integrim Evropian

Mbledhja nr. 52

Prishtinë, më 19. 03. 2010, në orën 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

**PROCESVERBAL**

**I mbledhjes së Komisionit për Integrim Evropian**

**Në mbledhje morën pjesë:** Zylfije Hundozi, Edita Tahiri, Fatmir Rexhepi, Njomza Emini, Nait Hasani dhe Naser Rugova. **Munguan:** Bujar Bukoshi, Džezair Murati dhe Petar Miletiq.

**Me ftesë:** Edon Cana - shef i Agjencisë për Koordinim të Zhvillimit dhe të Integrit Evropian.

**Nga Stafi Mbështetës i Komisionit:** Ahtere Loxha dhe Adelina Demolli.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Blerim Vela - përfaqësues i OSBE-së, Dardan Sadriu - AKZHIE, Isuf Zejna - KDI, Besart Mustafa – praktikant dhe Mimoza Gojani - Ambasada Britanike.

**Mbledhjen e kryesoi Zylfije Hundozi** - kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të datës 10. 03. 2010,
3. Prezantimi i shefit ekzekutiv të Agjencisë për Koordinimin e Zhvillimit dhe të Integrit Evropian, Edon Cana,
4. Shqyrtimi i Projektligjit për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së,
5. Shqyrtimi i Projektligjit për Gazetën Zyrtare me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së,
6. Të ndryshme.

*Kryesuesja konstatoi se ish-in plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen.*

## 1. Miratimi i rendit të ditës

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

## 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me 10. 03. 2010

**Kryesuesja** konstatoi se *procesverbali i datës 10.03.2010 u miratua pa vërejtje.*

## 3. Prezantimi i shefit ekzekutiv të Agjencisë për Koordinimin e Zhvillimit dhe të Integritimit Evropian, Edon Cana,

**Kryesuesja** - Ju kemi ftuar me qëllim që të na njoftoni për mënyrën e shfrytëzimit të Instrumentit të Para Anëtarësimit (IPA) në Kosovë, sepse ka kritika të shumta nga shoqëria civile se nuk po dimë t'i shfrytëzojmë këto fonde. Dëshiroj të di a ka mundur Kosova t'i shfrytëzojë këto fonde më mirë dhe a kemi pasur mundësi të ndikojmë drejtpërdrejt me projekte në mënyrën e shfrytëzimit të tyre?

**Edon Cana** - Tha se IPA-ja programohet një vit para implementimit. Unë po jua dorëzoj programet e IPA-së 2009 në mënyrë që të jeni të informuar se cilat janë projektet që do të implementohen këtë vit. Sa i përket Kosovës ceku se ka sistem të centralizuar të menaxhimit të IPA-së, që do të thotë se të gjitha tenderimet, selektimet dhe implementimet bëhen nga një delegacion special - në këtë rast Zyra Ndërlidhëse e Bashkimit Evropian. Ne mundohemi që duke u bazuar në prioritetet e programit të Qeverisë t'i japim këshilla Komisionit Evropian që të miratojë fondet bazuar në ato prioritetet. Sa u përket fondeve të IPA-së kemi qasje vetëm në shtyllën e parë të saj. Kjo shtyllë është e koncentruar në përmbushjen e kriterëve të Kopenhagës, siç janë kriteret ekonomike, politike dhe në përafrimin e legjislacionit. Për fondet e shtyllës së parë kemi ndikim vetëm në përpilimin e projekteve, sepse vendimi merret nga Komisioni Evropian. Shtoi se janë duke bërë përpjekje që ndikimi i tyre të jetë maksimal. Në shtyllën e dytë kemi qasje për herë të parë vetëm për projektet ndërkuftare. Qasjen në shtyllën e dytë e konsiderojmë fitore shumë të madhe. Sa u përket projekteve ndërkuftare kemi pasur takime me përfaqësuesit e Shqipërisë dhe të Maqedonisë. Kemi krijuar struktura operacionale dhe *task forcën* e cila do të jetë përgjegjëse për përpilimin e projekteve strategjike të bashkëpunimit ndërkuftar. Shuma totale, që e kemi fituar është 1.2 milion euro. Kjo shumë është simbolike duke e pasur parasysh rekomandimin e Komisionit Evropian në Studimin e fizibilitetit, ku thuhej që bashkëpunimi ndërkuftar të prezantohet në mënyrë progresive. Si institucion përgjegjës në shkallë kombëtare, sa u përket çështjeve të bashkëpunimit ndërkuftar, është Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ndërsa Agjencia vetëm si koordinator i përgjithshëm. Sa u përket përfitimeve, që ka pasur Kosova në vitin 2008-2009, tha se për vitin 2008 kanë qenë 100 e 6 milionë euro, ndërsa në bazë të kalkulimeve Kosova çdo vit përafërsisht duhet të fitojë 62 milionë euro. Kjo shumë e reflekton një shumë që BE-ja e ka prezantuar në Konferencën e Donatorëve. Kjo do të thotë se ka qenë trefishi i shumës normale. Sa i përket procesit të tenderimit dhe të kontraktimit është çështje që menaxhohet nga Komisionit Evropian, ndërsa roli i Agjencisë është vetëm lehtësues dhe këshillues. Projektet janë të ndara sipas tri kriterëve: kriterëve ekonomike, politike dhe të standardeve evropiane. Në Kornizën Investuese për Ballkanin Perëndimor janë prezantuar projektet që janë miratuar. Ato do të zbatohen dhe së shpejti do të jenë publike. Është fabrika e re e ujit që do të bashkëfinancohet nga KfV-ja, nga Qeveria e Kosovës, nga Komuna dhe nga Zyra ndërlidhëse e Komisionit Evropian. Është fituar një grant prej 25 milionë eurosh për studimin e fizibilitetit për ujërat e zaza në shtatë qendra rajonale. Ky projekt është në harmoni me standardet evropiane. Po ashtu është fituar projekti për riparimin e TERMOKOS-it dhe së shpejti do të fillojë faza e tretë, që është lidhja e tij me termocentralin. Ky projekt do të realizohet nga KfV- Gjermane. Këto mjete vijnë sipas premtimit të saj në Konferencën e Donatorëve. Korniza Investuese për Ballkanin Perëndimor i mbledh të gjitha bankat, që janë investuese në Bashkimin Evropian, por fatkeqësisht Kosova nuk ka qasje në të gjitha bankat përveç në KfV-Gjermane. Shtoi se jemi duke pritur që të bëhemi anëtare të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, në mënyrë që të kemi qasje në fondet e saj. Prandaj kjo kornizë e ofron grupin e të gjitha bankave në një vend me qëllim të miratimit të projekteve, të cilat fillimisht miratohen nga vetë

komiteti drejtues i Kornizës Investuese për Ballkanin Perëndimor. Pra një herë miratohet nga Komiteti drejtues, alokohen mjete dhe pastaj shihen mënyrat si do të financohet një projekt. Kosova vitin e kaluar ka pasur qasje prej 3% në Kornizën Investuese për Ballkanin Perëndimor, në kuadër të fondeve investuese, ndërsa tani ka qasje 16%. Ne jemi të hendikepuar, sepse nuk kemi qasje në të gjitha bankat, në të cilat vendet e rajonit kanë qasje.

**Naser Rugova** - Konsideroj se për herë të parë po zhvillohet një takim qenësor ndërmjet Komisionit për Integritet Evropian dhe Agjencisë. Kemi pasur paqartësi të mëdha se çka po ndodh me fondet e IPA-së dhe me menaxhimin e tyre. Deri më tash kemi parë marketing shumë të madh medial lidhur me fondet e fituara, por nuk kishim edhe zbatim të tyre. Sa u përket investimeve të Komisionit Evropian në shumë sektorë nuk ka rezultate të kënaqshme. Ende nuk kemi qasje në këto institucione të rëndësishme, nga të cilat vendet e rajonit kanë përfituar shumë, si për mbrojtjen e ujit, si për menaxhimin e mbeturinave etj. Këto probleme janë përditshmëri jona. Propozimi vjetor i IPA-së për 2009, që ka të bëjë me sundimin e ligjit dhe të rendit, është inkurajues, mirëpo po t'i shohim këto shifra dhe po ta lexojmë Raportin e Progresit për gjyqësorin e Kosovës, do të gjejmë mosrputhje të madhe. Dihet se fondet e IPA-së nuk i menaxhojnë institucionet e Kosovës. Për mua është shumë e çuditshme që për rininë dhe për sportin janë paraparë 14 milionë euro, ndërsa buxheti vjetor i kësaj ministrie është 20 milion. Kjo do të jetë një mbështetje e madhe për këtë ministri dhe duhet të shohim rezultate shumë të mëdha në këtë drejtim. Nëse shohim me kujdes Korniza Investuese për Ballkanin Perëndimor i ka katër pikat kryesore, në të cilat është fokusuar: energjia, mjedisi, sektori social dhe transporti. E paraqit një pasqyrë sepse Komisioni ynë është në dijeni për procedurat, për mjetet por edhe për marketingun e madh që është bërë për këto mjete. Duhet të jemi të kujdesshëm me donacionet dhe me kreditë. Kjo është përgjegjësi juaja dhe e Qeverisë që të keni kujdes me asetet kombëtare të Kosovës. Ka pasur tendenca që edhe para shpalljes së Pavarësisë IBRD-ja t'i jepte kredi Aeroportit të Kosovës 16 ose 20 milionë. Ne mund të hyjmë në partneritet publiko-privat sipas ligjit dhe të krijojmë kushte dhe lehtësi që të zhvillohet biznesi, por sipas tregtisë së lirë dhe të interesave kombëtarë që i ka Kosova. E kemi edhe një hendikep, sepse nuk i kemi strategjitë e miratuara në Kuvend. Nëse do të shkoni të negocioni për ndonjë projekt, pyetjen e parë që do t'ju bëjnë do të jetë: A keni strategji kombëtare? Për fund duhet t'ju informoj se shumica e dikastereve që ndërlihen me këto katër pika ende nuk e kanë kryer punën e tyre.

**Edita Tahiri** - U inkurajova nga aktivitetet që i keni bërë për tërheqjen e këtyre fondeve dhe më erdhi mirë që Kosova qenka më përpara se disa vende të rajonit. Pyes a jemi në gjendje t'i implementojmë të gjitha këto investime? Dihet se parim i integritetit evropian është që kreditë dhe fondet që merren nëse implementohen me sukses hapin shtigje më të mëdha për marrje të reja. Po ashtu pyeti si qëndrojmë me kapacitete, që të dëshmojmë se këto projekte po zbatohen dhe jemi në gjendje që t'i vazhdojmë. Është traditë e vendeve në rajon që për shkak të mungesës së kapaciteteve ta humbim këtë mundësi. Kosova me këto vështirësi që i ka, nuk duhet t'i humb këto raste.

**Nait Hasani** - E falënderoi për paraqitjen e strukturuar që bëri Cana. Deshi të dinte për çështjen e hekurudhave. Kosova i ka dy dalje të hekurudhave, andaj çka është planifikuar në këtë drejtim? Dua të di se a është ky projekt për hekurudhën Prishtinë-Aeroport? Nëse do të ndërtohet hekurudhë e re a do të jetë e destinuar për udhëtarë apo për transport të mallrave? Po ashtu është projekti tjetër me të cilin do të lidhet Prizreni me Shqipërinë nëpërmjet hekurudhës, sepse do të ketë qarkullim shumë më të lirë të mallrave, që do të vërehej edhe me lirim të mallrave. A ekziston ndonjë projekt konkret për këtë lidhje, sepse sa jam në dijeni se Shqipëria vetëm se do ta fillojë implementimin e këtij projekti. Sa i përket hekurudhës Xërx – Prizren, është e demoluar. Ndërsa sa i përket ndihmës që ofrohet për arsimin dua të di a ka kritere për këtë ndihmë? Cilave institucioneve arsimore do t'u ofrohet ndihmë?

**Edon Cana** - Ritheksoi se roli i IPA-së nacionale është përmirësimi i kritereve të Kopenhagës. Këto fonde janë të dedikuara për ngritjen e kapaciteteve administrative, për menaxhimin e kufijve, do të thotë për sendet të paprekshme. Të hollat e vërteta vijnë me shtyllat 3, 4 dhe 5, të cilat janë fonde

për subvencione dhe janë para-hyrje të fondeve strukturore. Prej nesh kërkohet një herë ta arnojme thesin, pastaj t'i fusim gjërat brenda. Sa i përket borxhit publik Ministria e Ekonomisë dhe e Financave është e vetmja që mund të hyjë në borxhe publike. Sa u përket kredive ato nuk jepen si më parë dhe duhet të kemi garanci shumë më të forta se më parë. Për të marrë kredi në BERZH na nevojiten 44 vota, ndërsa ne i kemi 37 vota, andaj posa të anëtarësohemi, do të kemi qasje në to. Lidhur me pyetjen e deputetes Tahiri është e vështirë të përgjigjem, sepse të gjitha donacionet menaxhohen nga donatorët dhe nga shtetet bilaterale, të cilat raportojnë në shtetet e tyre, sepse janë të holla të taksave të qytetarëve të tyre, andaj nuk kemi hise në to. Të gjitha projektet duhet si parakusht ta kenë Studimin e fizibilitetit. Komisioni Evropian Studimin e fizibilitetit e lidh drejtpërdrejt me aftësinë e financimit të projektit. Si fazë e parë e projekteve janë vlerësimi i situatës në terren dhe rekomandimet konkrete. Sa i përket aftësisë për implementim nuk mund të them se Kosova është më mirë se rajoni, por kemi burokraci shumë më pakë se vendet e rajonit, sa i përket donacioneve. A do të vijmë në situatë që donatorët të ikin nga Kosova, nuk mund të them po ose jo. Duke parë punën që e kemi bërë, nuk besoj se do të ikin. Ne kemi bërë databazë të përgjithshme në lidhje me fondet dhe në afat dymujor do të kemi qasje të plotë në faqe të internetit, në të cilën do të kemi informata të plota për donacionet që vijnë. Njoftoi se janë në fazën përfundimtare dhe se do t'i njoftojë kur kjo platformë të jetë aktive.

**Edita Tahiri** - Nuk u mora me atë sa duhet të jetë llogaridhënia e donatorëve për qytetarët. Por a dispononi ju me ndonjë analizë, në të cilën shihet se në disa fusha kemi kapacitete më të mira për të implementuar projektet e në disa jo.

**Edon Cana** - Nuk kemi ndonjë analizë, por kemi dallime shumë të mëdha ndërmjet ministrive. I Shembull për këtë e kemi Ministrinë e Punëve të Brendshme që ka aftësi shumë të mira për procesin e integriteteve. E kemi projektin TWINING, që do t'i përkrahë Agjencinë, Komisionin për Integritet Evropian, si dhe ministrinë e linjave. Ky projekt është duke i analizuar kapacitetet e këtyre institucioneve për menaxhimin e fondeve të Bashkimit Evropian. Ne mund t'ua dërgojmë informatat të cilat do t'i marrim pasi projekti t'i ketë hartuar raportet për secilin institucion. Sa i përket pyetjes së deputetit Hasani prioritetet caktohen me Ministrinë e Transportit. Prioritet, për arsye ekonomike, është rehabilitimi i korridorit numër dhjetë – Leshak - Mitrovicë - Fushë-Kosovë – Ferizaj - Hani i Elezit. Sa i përket prioritetit të dytë, krijimi i një linje që do të lidhë Prishtinën me Aeroportin, do të presë deri sa të bëhet koncesionimi i Aeroportit. Për projektet e tjera nuk do të kemi mundësi të sigurojmë fonde. Ne e bëjmë projektin themelor, ndërsa gjithë vlerësimin e situatës në terren e bën Komisioni Evropian. Për projektet që janë të vogla mund të fitojmë grante, ndërsa për ato të mëdha duhet të sigurojmë bashkëfinancim.

**Kryesuesja** - E dimë se Plani i Veprimit është shumë voluminoz dhe vetë Komisioni Evropian e ka paraqitur si dokument shumë të komplikuar. A është rishqyrtuar Plani i Veprimit? Nëse po, cilat janë prioritetet tani, pas rishqyrtimit të tij? A keni qasje në buxhet për implementimin e veprimeve të Planit dhe a konsultoheni që t'i paraqitni kërkesat tuja në buxhet? A është implementuar Plani i Veprimit nga dikasteret përgjegjëse? Në vitin 2008 është hartuar Plani strategjik për integritet evropian, në të cilin janë paraqitur disa struktura, duke filluar nga Kryeministri, Kryetari e të tjerë. Ne i kemi caktuar deputetët që të marrin pjesë në grupe pune, por këto grupe nuk funksionojnë. Pse nuk funksionojnë këto grupe?

**Edon Cana** – E kemi rishqyrtuar Planin e Veprimit dhe i kemi identifikuar dhjetë veprime konkrete. Njoftoi se e kanë përgatitur një udhëzim administrativ me të cilin kërkohet forcimi i zyrave për integritet në të gjitha ministrinë. Dhjetë prioritetet janë në harmoni të plotë me kritikën që i ka paraqitur Raporti i Progresit. Gjatë rishikimit të Planit të Veprimit e kemi miratuar një teknik të re. Besojmë se do ta kemi një dokument më strategjikë, më të thjeshtë dhe më të zbatueshëm. Besojmë se brenda prillit do ta dërgojmë për miratim në Qeveri. Është më rëndësi se këtë vit do të kemi partneritet të ri nga Komisioni Evropian dhe do të përgatitemi për të. I kemi funksionalizuar të gjitha institucionet e parapara në Planin për Integritet. Për herë të parë është funksionalizuar Këshilli

Ndërministror dhe Komiteti i Punës. Njoftoi se Këshilli Ndërministror deri më tash ka mbajtur katër takime.

**Kryesuesja** - Kam marrë pjesë në takimet e Këshillit Ndërministror, mirëpo nuk kishte debate përmbajtjesore. Në këto takime Qeveria po diskuton vetëm për të gjeturat e Raportit t Progresit e jo edhe të dokumentit tjetër që është i një rëndësie shumë të madhe, pra Studimi për Kosovën. Në të përmendet marrëveshja tregtare pesëvjeçare për Kosovës. A nuk është e disfavorshme ajo marrëveshje për Kosovën?

**Edon Cana** – Më se 90% e Planit të Veprimit është në përputhje të plotë me Kornizën afatmesme të shpenzimeve. Ne jemi Agjenci me resurse të limituara. Kemi detyrime për t'i menaxhuar dy procese shumë të rëndësishme, siç janë procesi i integritimeve dhe mbikëqyrja e donacioneve. Njoftoi se vlerësimi i ndikimit buxhetor do të bëhet tash e tutje çdo vit. Neve na jepen preferenca për importimin e mallit dhe për heqjen e doganave për të gjitha mallrat. Kjo e ka për qëllim stimulimin e bizneseve të Kosovës. Marrëveshja ka qenë deri në dhjetor 2010, ndërsa tash Komisioni Evropian e ka miratuar të zgjatë deri në vitin 2015. Në të njëjtën kohë ka propozuar të fillojnë negociatat për marrëveshje tregtare. Qëllimi i marrëveshjes tregtare është shumë më qenësor se tarifrat preferenciale, që i ofrojnë, sepse marrëveshja tregtare përbën Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit. Kjo ka ta bëjë me procesin e integritimit të Kosovës në BE. Mosnjohja e Kosovës nga pesë shtetet gjithmonë do të ndikojë në fjalorin që ia paraqet Komisioni Evropian Kosovës.

**Kryesuesja** - E falënderoi Canën për prezantimin dhe shprehu gatishmërinë që në të ardhmen të vazhdojë ky bashkëpunim. Për shkak të jovazhdimësisë së bashkëpunimit me Agjencinë shpresojmë ta nënshkruajmë memorandumin e mirëkuptimit, me të cilin do të rritej bashkëpunimi ndërmjet këtyre dy institucioneve.

#### **4. Shqyrtimi i Projektligjit për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së**

**Kryesuesja**, ftoi deputetin Naser Rugova-referues i këtij projektligji të paraqet Raportin për këtë projektligj.

**Naser Rugova** - Ky projektligj mund të procedohet më tutje, sepse nuk i cenon parimet e *acquis communitare*.

**Kryesuesja** konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë

#### ***Përfundim***

***Projektligji për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare me amendamentet e Komisionit Funkcional është në harmoni me acquis communitare.***

#### **5. Shqyrtimi i Projektligjit për Gazetën Zyrtare me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së**

**Kryesuesja** – E ftoi deputeten Edita Tahiri - referuese e këtij projektligji ta paraqet Raportin për këtë projektligj.

**Edita Tahiri** - Tha se ky projektligj mund të procedohet më tutje, sepse nuk i cenon parimet e *acquis communitare*.

**Mbledhja përfundoi në orën 13: 40 min.**

**E përgatiti:**

**Njësia për mbështetjen e komisioneve**

**Kryetare e Komisionit**

---

**Zylfije Hundozi**